



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 291/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Arlind Krasniqit simpatizant i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të mitos për blerjen e votave gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV)
Arsyetim

PZAP-i, më datë 09.06.2014 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 08.06.2014 rreth orës 11:00 në shkollën e mesme Gani Cavderbasha në vendvotimin 2042a/11r në Prizren një person me emrin Arlind Krasniqi përkrahës i LDK-së ka shitur vota në vlerë prej 10 euro. Sipas parashtresës të ankesës në po të njëjtin vend personi me emrin Nimete Kryeziu pasi që ka votuar në vendvotimin 2042/12r ia ka treguar fotografën Arlind Krasniqit, e i cili ishte me veturë të tipit Golf 5 me targa 04-772-AH dhe se për rastin në fjalë është raportuar edhe policia. Parashtresësi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e Bajram Sezallarit dhe Enis Shkurtit vëzhguese të LVV-së.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 11.06.2014 deri në ora 10:00

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK, në të cilën përgjigje theksohet se ankesa në fjalë është e pabazuar pasi që personi i përmendur Arlin Krasniqi për LDK është person i panjohur dhe se nga deklaratat e dhëna të nga ana e zyrtareve të LVV-se nuk vërtetohet në asnjë mënyrë lidhja e këtij personi me LDK-në.

PZAP-i lidhur me këtë e njoftoi Policinë e Kosovës dhe kërkoi që të ofroj informacionet e kërkuar për rastin në fjalë.

Në raportin e policisë të Kosovës theksohet se nuk kanë pasur asnjë raport lidhur me diçka të tillë, pra nuk është ankuar askush nga komisionarët apo vëzhguesit tek njësitet policore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që në vendin për të cilin është pretenduar për parregullsit e theksuara me ankesë, policia e Kosovës nuk është raportuar për ndonjë parregullsi nga ndonjë vëzhgues apo nga ndonjë komisioner i këtyre vendvotimeve. Prandaj PZAP-i duke pasur parasysh se një pretendim i tillë nuk është arritur që të argumentohet me ndonjë fak, ka konstatuar se kjo ankesë është e pa bazuar dhe është pa argumentuar me ato për çfar u tha në ankesë, andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 291/2014 më datën 12.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*